

## REZOLUTË

### PËR GJENDJEN E EMERGJENCËS NË QARKUN E SHKODRËS DHE MASAT E MARRA NGA QEVERIA PËR PËRBALLIMIN DHE NORMALIZIMIN E SITUATËS

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i mbledhur sot, në datën 18.1.2010, në një seancë të posaçme informimi dhe debati për gjendjen emergjencës në qarkun e Shkodrës:

#### **Pasi u njoh në detaje me:**

1. Fatkeqësinë e rëndë natyrore dhe gjendjen e emergjencës së krijuar prej saj të ditëve të fundvitit 2009 dhe ditëve të para të vitit 2010;

2. Masat e marra dhe përpjekjet e bëra nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, strukturat ekzekutive dhe ato të pushtetit vendor të qarkut të Shkodrës për përballimin e përmbytjes dhe normalizimin e situatës;

3. Menaxhimin profesional dhe të përkushtuar të situatës hidrike në kaskadën e Drinit nga ana e strukturave të Korporatës Elektroenergetike Shqiptare;

4. Si dhe shembujt e çmuar të ndihmës dhe të solidaritetit njerëzor me banorët e zonave të përmbytura;

**Falënderon** dhe shpreh mirënjohjen për qytetarët e Shkodrës dhe të Nënshkodrës për kurajën dhe fisnikërinë e treguar gjatë gjithë ditëve të vështira të emergjencës së krijuar nga përmbytja.

**Vlerëson** përpjekjet maksimale të Qeverisë dhe të Komitetit Ndërmintor për Gjendjen e Emergjencës në Shkodër, nivelin e lartë të gatishmërisë së treguar, si dhe koordinimin e shkëlqyer që kanë realizuar.

**Shpreh konsideratën** për rolin e rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm që kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore dhe anëtarët e këshillave bashkiakë dhe komunalë në qarkun e Shkodrës.

**Shpreh mirënjohjen e thellë** për ndihmën dhe kontributin e sinqertë në njerëz, pajisje dhe ndihmë monetare që kanë dhënë vendet fqinje dhe mike: Italia, Franca, Austria, Greqia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Turqia, Sllovakia, Moldavia etj., si dhe organizmat ndërkombëtarë: NATO-ja, Komisioni Europian, Banka Botërore dhe PNUD-i.

**Falënderon** qytetarët shqiptarë për solidaritetin njerëzor, komunat dhe bashkitë e Shqipërisë për mbështetjen e pashembullt institucionale, deputetët e Kuvendit, kompanitë e biznesit, vendase dhe të huaja, për ndihmën thelbësore dhe të menjëhershme, nëpunësit dhe përfaqësuesit e institucioneve dhe enteve të pavarura për kontributet e çmuara, si dhe bashkësitë shqiptare në botë për ndihmën bujare.

#### **Vendosi:**

1. T'i kërkojë Qeverisë që të angazhojë të gjitha burimet financiare dhe njerëzore të saj për kapërcimin sa më të shpejtë të të gjitha pasojave të kësaj fatkeqësie natyrore.

2. T'i kërkojë Qeverisë të ndërmarrë të gjitha masat për vlerësimin real dhe objektiv, si dhe zhdëmtimin e plotë të të gjithë qytetarëve dhe familjeve të prekura dhe dëmtuara nga përmbytja.

3. Qeveria, ministritë dhe të gjitha agjencitë e vendit të nisin menjëherë punën për rehabilitimin e zonës së prekur, pastrimin mjedisor të saj, normalizimin sa më të shpejtë të jetës së njerëzve dhe veprimtarisë së tyre në këto zona.

4. Qeveria të përparësojë të gjitha projektet që i japin zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjatë parandalimit dhe përballimit të fatkeqësive të ngjashme natyrore.

5. Rishikimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor rregullator, në përputhje me standardet europiane në fushën e parandalimit dhe përballimit të fatkeqësive natyrore.

18 janar 2010